REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 3201 Prot. Maliq, më 23 / 6 /2025

PROJEKT- VENDIM
Nr. 10, datë 23/6/2025

"DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.128 DATË 26.12.2024 "PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMNISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË MALIQ,PENALITETET DHE SHKELJET APO KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 dt 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*" pika *c*, si dhe nenit 54 "*Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak*", pika *f*, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë*", ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 5 si dhe Vendimin nr. 128 datë 26.12.2024 të Këshillit të Bashkisë Maliq. "*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2025*",i propozoj Këshillit të Bashkisë:

I. Të miratojë disa ndryshime në Vendimim e Këshillit të Bashkisë nr.128, datë 26.12.2024 si më poshtë:

1.1 Të miratojë taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja në pikën 4:

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	**Niveli i taksës në % sipas ligjit**	**Propozohet në %**
Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin	Jo me shume se 1	1

1.2 Në pikën 2 të tabelës të llojeve të ndërtimeve dhe investimeve për përllogaritje të taksës së ndikimit në infrastrukutë të hiqet fjala "bujqësore" dhe niveli i taksës ngelet i pandryshuar si më poshtë:

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës në % sipas ligjit	Propozohet në %
Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike	1-3	2

Të bëhet:

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës në % sipas ligjit	Propozohet në %
Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike	1-3	2

II. Tek kreu B, tarifat vendore, pika 1.II.2.d, pika 2.II.2.d, pika 3.II.2.d, të shtohet: " Llogaritja e tarifave do të bëhet pëpjestimisht me afatin e kontratës, për kontratat e investimeve publike ".

III. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të bëjë ndryshimet në buxhetin e bashkisë për vitin 2025.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

V. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Korçë.

KRYETARI I BASHKISË
GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr320 /prot Maliq me 23 / 6 /2024

RELACION

Për

"DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.128 DATË 26.12.2024 "PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMNISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË MALIQ,PENALITETET DHE SHKELJET APO KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 dt 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*" pika *c*, si dhe nenit 54 "*Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak*", pika *f*, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për proçedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë*", ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 5 si dhe Vendimin nr. 128 datë 26.12.2024 të Këshillit të Bashkisë Maliq, "*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2025*",

Duke u bazuar në ndryshimin e Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" propozojmë ndryshimin e paketës fiskale duke pasqyruare ndryshimn ligjor sipas të cilit parashikohet:

"Në nenin 27, pika 3, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në shkronjën "a" fjala "buxhetore" hiqet.

2. Pas dikonjës "a" shtohet shkronja "a/1" me këtë përmbajtje:

"a/1. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin buxhetor dhe lotaral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e say."

Në pikën II të projekt vendimit propozojmë të bëhet një saktësim për përllogaritjen e tarifave vendore të kantiereve të ndërtimit, për kontratat e investimeve publike, përputhshmërisht me afatin e zbatimit të kontratës, kjo për të lehtësuar barrën paguese të subjekteve.

Jurist: J.Thomo

Përgjegjës sektori administrimi i lejave: R. Spaho

Drejtor i të Ardhurave: J.Grabocka

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ